

**STATUTI I SHOQERISE**  
**“ ORBIT STUDIO ” SH.P.K**

**THEMELIMI**

**Neni 1**  
**Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqeria **“ORBIT STUDIO” sh.p.k** themelohet nga ortaket:
- Z. Nexhmi TRUPJA , i biri i Sefulla-ut , lindur ne Peshkopi , me 30.03 1982, e banues ne Rr.Mahmut Allushi, Shk.2, Ap.8, Linze, Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me Nr.I20330004R.
  - Z. Gidian HAJDERAJ , i biri i Gezim-it , lindur ne Fier , me 29.04 1986, e banues ne Rr.Mujo Ulqinaku, , Shk.1, Ap.18, Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me Nr.I60429094N.

**EMERTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2**  
**Emertimi**

- 2.1 Emertimi i shoqerise eshte : **“ORBIT STUDIO” sh.p.k**

**Neni 3**  
**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar dhe eshte themeluar ne perputhje me legjislacionin tregtar ne Shqiperi.
- 3.2 Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.
- 3.3 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**  
**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqeria **"ORBIT STUDIO"sh.p.k** do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me kete statut, me aktin e themelimit, legjislacionin tregtar dhe aktet ligjore e nenligjore ne fuqi.

**Neni 5**  
**Kohezgjatja e veprimtarise**

- 5.1 Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete e pakufizuar.

## **Neni 6 Selia**

- 6.1 Selia shoqerise do jete ne adresen: Sheshi Karl Topia, Zona 17,Nd.32,Ap 6/482 TIRANE
- 6.2 Shoqeria mund te hape dege, filiale apo zyra perfaqesie si brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashte saj.
- 6.3 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera shqiptare qe ekzistojne ose do te krijohen ne te ardhmen ne Shqiperi.

## **Neni 7 Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqeria do te kete emblemen dhe vulen e saj. Vula do te perdoret nga administratori i shoqerise.
- 7.2 Forma dhe permasat e vules do te percaktohen ne perputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Te gjitha dokumentet e shoqerise duhet te permbajne emblemen dhe vulen e saj.

## **VEPRIMTARIA E SHOQERISE**

### **Neni 8 Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise do te perfshije :
  - Studim-Projektim-Konsulence per : studime urbanistike;ndertime civile,industriale , turistike,bujqesore; ambjentale,interieresh,peisazhe e restaurime,
  - Ndjekje dhe realizim punimesh ne te gjitha fazat e ndertimit deri ne perfundim te projektit
- 8.2 Objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Ortakeve.

## **KAPITALI I SHOQERISE**

### **Neni 9 Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 ( Njeqind mije ) leke.
- 9.2 Kapitali ndahet ne 2 (Dy ) pjese, me vlere nominale 50,000 (Pesedhjete mije ) leke e zoterohet 50 % nga ortaku Nexhmi TRUPJA dhe me vlere nominale 50,000 (Pesedhjete mije ) leke e zoterohet 50 % nga ortaku Gidian HAJDERAJ

**Neni 10**  
**Transferimi i pjeseve te kapitalit. Kufizimet.**

- 10.1 Pjeset e kapitalit mund te transferohen vetem me akt noterial te shkruar.
- 10.4 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Trashegimtarete do te regjistrojne titullin e pronesise ne regjistrin e ortakeve.

**Neni 11**  
**Rritja e kapitalit**

- 11.1 Me vendim asambleje ortaket mund te zmadhojne kapitalin nepermjet kontributeve te tij.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund te behet gjithashtu edhe nepermjet nenshkrimit dhe shlyerjes se pjeseve te tjera te kapitalit nga ortake te rinj. Ortaket e rinj pranohen dhe miratohen si te tille me vendim te Ortakeve ekzistues.

**Neni 12**  
**Zvogelimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogelimi i kapitalit behet sipas procedurave te parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogelimit do t'i paraqitet ekspertit kontabel te autorizuar dhe administratorit te pakten 45 dite perpara marrjes se vendimit nga Ortaket e shoqerise. Eksperti kontabel dhe administratori do te shqyrtojne propozimin dhe do t'i paraqesin ortakeve raportin ne lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogelimit te kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogelimit te kapitalit do te miratohet me vendim te Ortakeve te shoqerise.

**ORGANET E SHOQERISE**

**Neni 13**  
**Vendimet**

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarine e shoqerise merren nga ortaket Nexhmi TRUPJA dhe Gidian HAJDERAJ
- 13.2 Vendimet e Ortakeve drejtojne veprimtarine e shoqerise.  
Vendimet e Ortakeve perfshijne kryesisht:
- ndryshimin e statutit;
  - ndryshimin e selise, te emertimit te shoqerise;
  - hapjen e degeve, filjaleve ose perfaqesive te shoqerise;
  - rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise dhe marrjen e kredive;
  - shitjen ose transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar paleve te treta;
  - prishjen dhe likuidimin e shoqerise;
  - emerimin ose shkarkimin e administratorit ose administratoreve te shoqerise;

- miratimin e bilancit te shoqerise;
- transformimin e shoqerise ne forma te tjera;
- pjesemarrjen e shoqerise si aksionere ose ortakne ne shoqeri te tjera.

#### **Neni 14 Administrimi**

- 14.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nje grup administratoresh qe caktohen me vendim te Ortakeve
- 14.2 Administratoret kane te drejte te perfaqesojne shoqerine dhe drejtojne punen e perditshme te shoqerise ne perputhje me udhezimet e te Ortakeve
- 14.3 Administratoret jane pergjegjes per veprimtarite e meposhtme:
- drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise duke respektuar vendimet e Ortakeve;
  - perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet, perfshire edhe institucionet bankare, personalisht ose me perfaqesim;
  - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
  - emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se eshte e nevojshme;
  - pergatitjen e dokumentave ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe kane;
  - lidhin kontrata pune dhe i zgjidhin ato sipas rastit;
  - zhvillojne veprimtari te tjera te cdo lloj natyre per te miren e shoqerise dhe realizimin e objektit te saj.
- 14.4 Administratori i shoqerise eshte Ortaku Z. Gidian HAJDERAJ.
- 14.5 Mandati i administratoreve do te jete i vlefshem deri ne castin e revokimit te tij me vendim te Ortakeve

#### **RREGULLIME TE TJERA**

##### **Neni 15 Ekspertet kontabel te autorizuar**

- 15.1 Ekspertet kontabel te autorizuar do te emerohen me vendim te Ortakeve

##### **Neni 16 Viti financiar**

- 16.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar me 31 Dhjetor te cdo viti.
- 16.2 Si perjashtim, viti i pare financiar i shoqerise do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise ne QKB.

**Neni 17**  
**Bilanci. Kontabiliteti.**

- 17.1 Bilanci vjetor i shoqërise shqyrtohet nga Administratori dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

**Neni 18**  
**Likuidimi**

- 18.1 Prishja e shoqërise vendoset me vendimin të përbashkët ortakësh
- 18.2 Me vendimin e ortakëve caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjendjen ekonomike të shoqërise, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për perfundimin e tij. Në perfundim të kësaj procedure, Ortaket do të shqyrtojnë bilancin perfundimtar dhe do të miratojnë perfundimin e procedurave të likuidimit.

**Neni 19**  
**Mosmarreveshjet**

- 19.1 Mosmarreveshjet që mund të lindin midis shoqërise dhe të tregëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.


**Neni 20**  
**Klauzole mbyllesë**

- 20.1 Ky Statut hartohet në 5 (pese) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtte ligjore.

**ORTAKET:**


**NEXHMI TRUPJA**

(emer, mbiemer, nënshkrim)

Nexhmi Trupja  


**GIDIAN HAJDERAJ**

(emer, mbiemer, nënshkrim)

Gidian Hajderaj  


**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË “ORBIT STUDIO” Sh.p.k.**

Sot, me datë 04.03.2021

**Z. Nexhmi TRUPJA**, shtetas Shqiptar, lindur më 30/03/1982, në Peshkopi, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr. Nr.120330004R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

**Z.Gidian HAJDERAJ**, shtetas Shqiptar, lindur më 29/04/1986, ne Fier, Shqiperi, mbajtëse pashaportës me nr. l60429094N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **“ORBIT STUDIO “Shpk** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është **“ORBIT STUDIO” Sh.p.k.**

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Sheshi Karl Topia, Zona 17,Nd.32,Ap 6/482 TIRANE  
Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

### NENI 3

#### KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

### NENI 4

#### OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Studim-Projektim-Konsulence per : studime urbanistike;ndertime civile,industriale , turistike,bujqesore; ambjentale,interieresh,peisazhe e restaurime,
- Ndjekje dhe realizim punimesh ne te gjitha fazat e ndertimit deri ne perfundim te projektit

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblymimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

### NENI 5

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 leke dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Nexhmi TRUPJA**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Leke dhe 50.000 Leke të kapitalit themeltar.
- **Z. Gidian HAJDERAJ**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Leke dhe 50.000 Leke të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm i shoqërisë është **Z. Gidian HAJDERAJ**, shtetas Shqiptar, lindur më 29/04/1986, në Fier, Shqiperi, mbajtës I pasaportes me nr.160429094N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE


Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar Gidian Hajderaj shtetas Shqiptar, lindur më 29/04/86 në FIER Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr. 160429094N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKËT THEMELUES

**Z. Nexhmi TRUPJA**

Nexhmi Trupja



**Z. Gidian HAJDERAJ**

Gidian Hajderaj

